

Njoftim i përqendrimit me të cilin ORBIKO SHPK për tregti Zagreb, Kroaci dhe "ASNOVA HOLDING", Ukrainë fitojnë kontroll të përbashkët mbi "SAV 92", Ukrainë

(lënda nr. 08-110/2023)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 19.07.2023, e plotësuar më 31.07.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët ORBIKO SHPK për tregti Zagreb, me seli në rr. Koturashka Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë, dhe Shoqëria Aksionare private "ASNOVA HOLDING", me seli në rrugën Mikola Krasnova nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë, mbi Shoqërinë aksionare në pronësi private "SAV 92", me seli në rrugën Mikoli Krasnova nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

ORBIKO SHPK për tregti Zagreb Lënda kryesore e operimit të ORBIKO SHPK Zagreb për tregti është tregtia me shumicë dhe në të njëjtën kohë është përfaqësues dhe distributor në territorin e Republikës së Kroacisë për një numër të madh markash duke filluar nga produktet e kujdesit dhe bukurisë, produktet ushqimore dhe jo ushqimore, pajisjet teknike dhe elektrike, ilaçet, lodrat, tekstilet, cigaret, vajrat e motorit dhe shumë produkte të tjera.

ORBIKO SHPK për tregti Zagreb ka një shoqëri të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Shoqëria për tregti dhe shërbime ORBIKO SHPK Shkup, me seli në rr. Boris Trajkovski nr. 286, Shkup. Lënsa kryesore e operimit të ORBIKO SHPK Shkup është tregtia jo e specializuar me shumicë dhe në të njëjtën kohë është përfaqësues dhe distributor në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për një numër të madh produktesh ushqimore të markave, vajra motori, bateri, parfume, ujëra tualeti dhe deodorantë, kozmetikë dekorative, produkte të higjienës personale, produkte kujdesi, produkte higjienike shtëpiake.

Shoqëria aksionare private "**ASNOVA HOLDING**" është me objekt operimi - veprimtari të tjera financiare-shërbyese, përveç fondeve të sigurimit dhe pensioneve, të pa përmendura diku tjetër.

Shoqëria aksionare private "**SAV 92**", është me objekt operimi - Tregti me shumicë jo e specializuar.

Përpara zbatimit të përqendrimit, Shoqëria Aksionare në pronësi private "SAV 92" do të blejë 100% të kapitalit themelor të shoqërive të mëposhtme në Ukrainë:

- Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "BENICE", me seli në rrugën Mikoli Krasnova nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë, me objekt operimi – Tregtia me shumicë jo e specializuar;
- Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "SAVSERVICE-MOVA", me seli në rrugën Mikoli Krasnova nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë, objekt operimi – Tregtia me shumicë jo e specializuar e ushqimeve, pijeve dhe produkteve të duhanit;
- Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "PROMO SERVICE", me seli në rrugën Mikoli Krasnova nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë, me objekt operimi – Agjencitë e marketingut;

Para përqendrimit, Shoqëria Aksionare në pronësi private "ASNOVA HOLDING" zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare private "SAV 92";

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

01.08. 2023